



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

RELACION

MBI AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR TË
NËNSHKRUAR KONTRATËN E GRANTIT TË PROJEKTIT "SHËRBIME
MULTIFUNKSIONALE NË SEKTORIN E ARSIMIT" FINANCUAR NGA
PROGRAMI EU4MUNICIPALITIES.

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, në kuadër të Skemës së Granteve Bashkimi Europian për Bashkitë (EU4Municipalities), me mbështetjen financiare të Komisionit Europian, pas aplikimit të suksesshëm, është përzgjedhur fituese e grantit prej 180,000 euro për projektin "Shërbime multifunkionale në Sektorin e Arsimit" financuar nga Programi EU4Municipalities i Komisionit Europian.

Bashkia Berat do të kontribuojë me bashkëfinancim për mbulimin e kostos së TVSh-së së Projektit (20%) në shumën 36,000 euro dhe me mbulimin e bashkëfinancimit në shumën 20,000 euro (10%), kosto e cila mbulohet nga zëri "kosto stafi" të ekipit të Bashkisë Berat që do punojë për Projektin.

Projekti më sipër parashikon ndërhyrje rehabilituese në ish-godinën e SHIK, për t'a kthyer në një Qendër për Shërbimet Arsimore të Bashkisë Berat, rehabilitim të pjesëshëm të kopshtit Moravë dhe Shkollës së Mesme Dyshnik, dhe disa aktivitete të lidhura me shërbimet më sipër, si blerje mjetesh didaktike për kopshtet dhe aktivitete vizibiliteti.

Nga ana e Donatorëve kërkohet miratimi i Këshillit Bashkia Berat për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Berat për të nënshkruar Kontratën e Grantit të Projektit.

Do të kërkonim nga ana juaj, autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Berat për të nënshkruar në emër të Bashkisë Berat Kontratën e Grantit për pjesëmarrjen e Bashkisë Berat në projektin "Shërbime multifunkionale në Sektorin e Arsimit" financuar nga Programi EU4Municipalities.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO



Konc. E. Dhimag

Adresa: Blvd. "Republika 2", Berat 5001, Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,
Ëëësite: www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

RELACION

Miratimin e kontributit të Bashkisë Berat për mbulimin e kostove të TVSH (20%) dhe kostove të bashkëfinancimit (10%) të Kontratës së Grantit të Projektit 'Shërbime multifunkionale në Sektorin e Arsimit' financuar nga Programit EU4Municipalities''

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, në kuadër të Skemës së Granteve Bashkimi European për Bashkitë (EU4Municipalities), me mbështetjen financiare të Komisionit European, pas aplikimit të suksesshëm, është përzgjedhur fituese e grantit prej 180,000 euro për projektin ''Shërbime multifunkionale në Sektorin e Arsimit'' financuar nga Programi EU4Municipalities i Komisionit European.

Projekti më sipër parashikon ndërhyrje rehabilituese në ish-godinën e SHIK, për t'a kthyer në një Qendër për Shërbimet Arsimore të Bashkisë Berat, rehabilitim të pjesshëm të kopshtit Moravë dhe Shkollës së Mesme Dyshnik, dhe disa aktivitete të lidhura me shërbimet më sipër, si blerje mjetesh didaktike për kopshtet dhe aktivitete vizibiliteti.

Bashkia Berat do të kontribuojë me bashkëfinancim për mbulimin e kostos së TVSh-së së Projektit (20%) në shumën 36,000 euro. Kontributi i Bashkisë për bashkëfinancim 36,000 euro do të parashikohet në buxhetin e vitit 2023 dhe PBA 2023-2025, në funksionin e arsimit 09.

Bashkia Berat do të kontribuojë me mbulimin e bashkëfinancimit në shumën 20,000 euro (10%) ,kosto e cila mbulohet nga zëri ''kosto stafi'' të ekipit të Bashkisë Berat që do punojë për Projektin.

Nga ana e Donatorëve kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak Berat për mbulimin e kostove të TVSH (20%) dhe kostove të bashkëfinancimit me kosto stafi (10%) të Kontratës së Grantit të Projektit 'Shërbime multifunkionale në Sektorin e Arsimit' financuar nga Programit EU4Municipalities''

Do të kërkonim nga ana juaj, miratimin e kontributit të Bashkisë Berat për mbulimin e kostove të TVSH (20%) dhe kostove të bashkëfinancimit (10%) të Kontratës së Grantit të Projektit 'Shërbime multifunkionale në Sektorin e Arsimit' financuar nga Programit EU4Municipalities''
Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO



Fonc. E. Dhima

Adresa: Blvd. "Republika 2", Berat 5001, Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 44 35
Ëbësite: eëë.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al